



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 19 tetor 2022, në mbledhjen e tretë (3) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:05

Në mungesë të Kryetarit të Komunës dhe Nënkyetares së Komunës, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, njëherit koordinator i KKS-së.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z.Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z.Shefki Selmani, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj.Sevdije Mustafa, përfaqësuese e komunitetit egjiptian; z.Xhafer Ademi, kryesues i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues i komunitetit rom; z.Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit-Podujevë; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z.Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile-Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe z.Shemsi Jashari, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore dhe z.Edolind Vishaj, përfaqësues i FSK-së.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesit e KFOR-it-Egyed, Csilla, përfaqësuesi i FSK-së (në zëvendësim të z. Edolind Vishaj) dhe z. Fatmir Rudari, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

z. Bahri Selimi, përshëndetje të gjithëve, pasi që Kryetari i Komunës për shkak të angazhimeve nuk mund të marr pjesë, e mungon po ashtu edhe Nënkyetarja e Komunës, ne do të fillojmë me mbledhjen e KKS-së. Në cilësinë e Koordinatorit të KKS-së më lejoni të hapi mbledhjen e tretë të KKS-së.

Materialet për mbledhje konsideroj se i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 15 gusht 2022

U miratua njëzëri

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- **Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë**
- **Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë**

z. Bahri Selimi, fillimisht falën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë **z. Nijazi Jashari**. **z. Nijazi Jashari**, theksoi, paraqes raportin që i referohet gjendjes së sigurisë në Komunën e Podujevës për periudhën janar – shtator 2022. Gjatë kësaj periudhe janë raportuar 712 raste të veprave penale, ndërsa krahasuar me vitin 2021 kanë qenë 787 raste të raportuara, pra këtë vit rreth 9.5% kemi më pak raste. Te zbulueshmëria kemi një rënie, nuk jemi të kënaqur, kemi diku rreth 13%. Na gëzon fakti që kemi ngritje të zbulueshmërisë të rastet NN me të panjohur, ku kemi pas një sukses më të mirë. Incidente të ndryshme të raportuara gjatë kësaj periudhë janë 240 raste, ndërsa në vitin 2021 në periudhë të njëjtë i kemi 283, pra rreth 15.2 % më pak, ndërsa zbulueshmëria e incidenteve ka rënie në 18% në këtë interval kohor. Sa i përket Planeve operative në periudhën kohore janar-shtator 2021 janë hartuar dhe zbatuar 99 plane operative, ndërsa në të njëjtën periudhë 2022 janë hartuar dhe implementuar 135 Plane operative, apo shprehur në përqindje 36.4 % më shumë. Protesta - 3 në këtë interval kohor, asistime në gjykata 2022 kemi 471, ndërsa në vitin 2021 472 asistime. Te KEDS-i kemi 3 asistime, ndërsa në vitin paraprak 8, asistime në Agjencinë e Pronave nuk kemi pas, ndërsa në vitin 2021 kanë qenë 8 raste të asistimeve, asistime të përmbaruesve privat i kemi 27 këtë vit, ndërsa 14 vitin 2021. Në Komunë i kemi 96 asistime, pika kontrolli i kemi 2508, armë të konfiskuara 47, municion të konfiskuar të kalibrit të ndryshëm 686 njësi. Kur jemi te asistimet, sa për sqarim, nuk i kemi llogaritur të gjitha sepse brenda javës kemi asistime në Drejtorinë rajonale të Prishtinës për aktivitete të ndryshme, si për lojëra të futbollit, vizita të delegacioneve të ndryshme etje. Asnjë lojë në Stadium të Prishtinës nuk zhvillohet pa qenë në asistencë. Në realizim të urdhëresave të Gjykatave jemi bukur mirë, gjatë periudhës raportuese janar-shtator 2021 kemi pranuar 109 urdhëresa, ndërsa në vitin 2022 në këtë interval kohor kemi pranuar 93 urdhëresa. Sikurse jeni në dijeni Qendra e ndalimit ekziston në Stacionin Policor ku ka katër dhoma, prej tyre një dhomë nuk është funksionale dhe sa për informim në këtë interval kohorë kanë qenë të arrestuar/ndaluar 123 persona. Angazhime në operativën në fushën e trafikut rrugor, për aksidente fatale nuk i kemi shifrat për arsye se me to merret trafiku rajonal, që e ka bazën në Fushë Kosovë. Aksidente me lëndime, këtë vit i kemi pas 35, ndërsa vitin paraprak kanë qenë 37, aksidente me dëme materiale 191 raste, krahasuar me përqindje kemi pas rënie nga viti paraprak me 12%. Tiketa të shqiptuara në vitin 2021 në këtë interval kohorë kanë qenë 5481, ndërsa në periudhën raportuese janar – 15.10.2022 kanë qenë 7117 tiketa. Persona të lënduar vitin 2021 kanë qenë 62, ndërsa këtë vit në intervalin e njëjtë kohor 52. Nënvizoi, kemi pas një takim me Drejtorinë Rajonale, me stafin udhëheqës në të cilin takim ka marr pjesë dhe Kryetari i Komunës. Kryetari ka pas kërkesa për shkak të trafikut dhe jemi duke bërë të pamundurën për aq sa kemi kapacitete për angazhimin e policëve në terren, sidomos në qytet, ku tregues është edhe numri i tiketave të shqiptuara.

Sa i përket parkingjeve edhe ne nuk jemi të kënaqur, aq më pak qytetarët. Jemi në mundim për të bërë aq sa kemi mundësi, kemi filluar me disa plane operative ad hoc. Siguria në shkolla është temë e veçantë dhe sa për njoftimin e juaj ne kemi tre zyrtar policor për sigurinë në shkolla të cilët operojnë në rroba civile. Për mungesën e stafit policor veç se jeni në dijeni, çështje këto që janë diskutuar edhe me Drejtorinë Rajonale bashkë me Kryetarin e Komunës. Sa për informim Stacioni Policor aktualisht ka mungesë të tre kapitenëve, dy togerëve, gjashtë rreshterë, pastaj kemi lëvizje të zyrtarëve policor, vetëm brenda një muaji kanë shkuar katër zyrtarë policor, një zyrtar policor ka dhënë dorëheqje dhe ka shkuar në gjermani. Është shqetësuese fakti ku një numër i zyrtarëve policor veç se presin të largohen. Sa i përket veturave të konfiskuara, deri më tani janë konfiskuar 155 , por ky numër nuk është sikurse që kanë qenë pritjet nga ne dhe Komuna, sepse operatori për bartjen e veturave nuk ka kapacitete që i referohen disa veturave pak më të rënda.

Sa i përket vjedhjeve të rënda, në këtë interval kohor kanë qenë 140 raste të raportuara, raste të vjedhjeve 65, grabitje është një rast që ka ndodhë në Hib Petrol para një jave, ku është grabitur një punëtor me të holla. Në këtë interval kohor kemi pas 3 vrasje, rastet në fshatrat; Pakashicë, Bajqinë dhe Gllamnik. Kjo është sa i përket Raportit dhe jam i hapur për përgjigje në pyetjet apo çfarëdo çështje që ju intereson lidhur me sigurinë në Komunën e Podujevës.

Përfaqësuesja e KFOR-it, theksoi ne jemi këtu të përkrahim çdo institucion të sigurisë dhe jemi përgjegjësi i tretë sipas renditjes. Gjithashtu desha të ju informojë se KFOR-i i pranon protestat paqësore. Gjithashtu një nga detyrat tona është që të bindim çdo këndë që ti përmbahet ligjit. Jemi të hapur gjithmonë dhe nëse keni nevojë mund të na drejtoheni.

Përfaqësuesi i FSK-së, theksoi, në mungesë të përfaqësuesit të FSK-së togerit Edolind Vishaj jam këtu prezent në zëvendësim të tij. Sa i përket kësaj periudhe kohore FSK nuk ka pas ndonjë aktivitet të theksuar në Komunën e Podujevës. Në aspektin e sigurisë, si ne e trajtojmë , situata vlerësohet e qetë dhe stabile.

z. Bahri Selimi, theksoi falënderojmë përfaqësuesit e institucioneve të sigurisë për raportin dhe informatat e paraqitura rreth sigurisë në Komunë. Unë e hap debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

z.Nijazi Jashari, po ndërlihem me diskutimin e përfaqësuesit të FSK-së. Sot kemi pas një informatë, në zonën e fshatrave Dobratin dhe Bradash ka pas gjuajtje me armë nga FSK, e cila është duke mbajtur ushtrime . Qytetarët kanë bërë thirrje telefonike sepse ka pas shqetësime nga ana e tyre.

Përfaqësuesi i FSK-së, theksoi, FSK çdo herë kur ka trajnime apo ushtrime nëpër poligone apo në lokacione tjera bëjnë trajnime me municion shkollor, andaj nuk ka vend për shqetësim .

z. Bahri Selimi, theksoi, sa i përket ushtrimeve të FSK-së që janë duke u mbajtur ne jemi njoftuar prej institucionit dhe kemi njoftuar edhe Policin e Kosovës për këtë ushtrim, ndërsa po rezulton që për shkak të shqetësimit të qytetarëve të bëhet një njoftim pak më i gjerë, në mënyrë që të jenë në dijeni edhe qytetarët. Mendoj që në të ardhmen FSK kur ka ushtrime të tilla të dilet me një njoftim për qytetarët që të jenë të njoftuar paraprakisht se do të ketë gjuajtje me armë.

z. Nuhi Selimi, theksoi , lidhur me raportin e Komandantit të Stacionit të Policisë, kur u përmendën kushtet për punë, dua të theksoj se zyrtarët policor në fshatin Orllan kushtet i kanë të rënda në raport lokacionet tjera, pra çështja është për vendqëndrimin e tyre për objektin e Stacionit policor. Është kërkesë e kahmotshme,, përfshirë edhe KLSB për

ndërtimin e një objekti të ri të Stacionit të Policisë në Orllan dhe nuk është bërë asgjë. Unë po e shfrytëzoj rastin që nëse ka mundësi të bëhet diçka në këtë drejtim. Është Stacion i vjetër, gjatë reshjeve të shiut uji depërton nga kulmi i objektit. Është mirë sa më shpejtë të bëhet një zgjidhje dhe të mos presin dimrin në atë objekt. Mendoj se është edhe obligim i Komunës që të angazhohet, në bashkëpunim me Stacionin Policor në Podujevë dhe me Drejtorinë rajonale të Policisë, sepse aty kanë vendqëndrim të përhershëm.

z.Nijazi Jashari, theksoi, vetëm desha të plotësojë parafolësin. Ne kemi pasur takime të rregullta të KLSB-së ku dhe e kemi trajtuar këtë çështje. Fakt që është problem, sepse objekti është shumë i vjetër. Kjo ka rrjedhë edhe si kërkesë e KLSB-së për fshatin Orllan.

z. Shemsi Jashari, theksoi, dëgjua raportimin e Komandantit të Stacionit Policor dhe nga ajo që po shihet ka bukur shumë probleme dhe sfida për këtë periudhë raportuese. Në mbledhjen e fundit të Kuvendit ka dalë në diskutim publik propozim Planin e Mobilitetit ku një numër i madh i çështjeve për të cilat edhe u raportua këtu kanë të bëjnë me Planin e Mobilitetit. Pamë që është një numër bukur i madh i tiketave të trafikut që janë shqiptuar. Po flasim për gjërat që qytetarët duhet paguar dhe nuk është që qëndrojnë mirë edhe financiarisht dhe kjo jo duke fajësuar policisë, por si shkak i shumë faktorëve rrethorë që i kanë detyruar qytetarët, që përveç pakujdesisë së tyre me shkeljen e rregullave të trafikut, por edhe për mungesën e parkingjeve dhe rrugëve të pamjaftueshme. Pra deri më datën 5 nëntor sipas njoftimit publik është që në këtë draft Plan të Mobilitetit, Policia e Kosovës në këtë rast në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse që është duke punuar në këtë dokument t'i adresojë me komente shqetësimet që i ka, duke marrë përbazë raportet që ka nga terrenet për pikat e zeza, problemet ku janë të koncentruara, çoftë problemet në trafik, me tiketat e shqiptuara ku ka më shumë, pra të bëhet pjesë e këtij propozim Planin të mobilitetit, në mënyrë që t'u mundësojë qytetarëve edhe lirinë e qarkullimit, pra t'i ketë të adresuar me theks të veçantë edhe këto probleme. Unë e përfaqësoj një grup që ka të bëjë me persona me nevoja të veçanta dhe ata kanë shumë shqetësime të lëvizjes së tyre në trafik për çështje të parkingut të rezervuar për këtë kategori dhe për tërë këto çështje besoj se edhe Policia ka informata. Në fund kisha propozuar nëse është e mundur që Ky këshill në këtë përbërje të organizojë një dëgjim publik për këtë propozim Planin të Mobilitetit për shkak që ka të bëjë me çështjen e sigurisë në shumë fusha, dhe secili nga fusha apo grupi që përfaqëson do të mund të kontribuonte me qëllim që ky plan të dal sa më i kompletuar. Koha se kur do të mbahej ky dëgjim, do të duhej para datës 5 nëntor pasi që kalon afati i diskutimeve publike. Ne kemi parë se ka filluar organizimi i diskutimit publik dhe do të ishte mirë të merren edhe rekomandimet prej dorës së parë për këtë çështje. Kjo nuk e ndalon edhe adresimin me shkrim dhe ndoshta do të ishte mirë që të bëhet edhe adresimi në formë të shkruar, por një dëgjim publik me pjesëmarrjen tonë besoj se do ishte një ndihmesë.

z. Bahri Selimi, theksoi, meqë u ndërlihdh tema të Planin e Mobilitetit e që ka të bëjë edhe me sigurinë publike në trafik, ne kemi filluar dëgjimet publike për projekt Planin e Mobilitetit dhe një prej tyre veç se është mbajtur. Për organizimin e një debati sikurse e theksoi parafolësi, kjo është kërkesë e juaja dhe kurdo që e vlerësoni ne jemi të gatshëm ta organizojmë një gjë të tillë. Meqë u propozua nga parafolësi, mendoj se duhet caktuar edhe një datë për organizimin e debatit. Pas takimeve të vazhdueshme që jemi duke i bërë për propozim Planin e Mobilitetit jemi në prag të organizimit të një takimi me ekspert të jashtëm të komunikacionit dhe me përfaqësues edhe të GIZ-it gjerman të cilët janë edhe sponsorizues të këtij propozim Planin dhe nëse e vlerësoni e vendosim që të ftoheni edhe ju në atë takim.

Konstatim

Njëzëri u dakorduan që më datë 26.10.2022 në ora 17:00 do të organizohet debati publik për propozim Planin e Mobilitetit ku do të marrin pjesë anëtarët e KKSB së bashku me grupin e ekspertëve të jashtëm të KKSB-së dhe përfaqësuesit e GIZ-it gjerman.

z. Bahri Selimi, nëse nuk keni diçka tjetër rreth kësaj pike të rendit të ditës, i falënderojmë për atë që na informuat për gjendjen e sigurisë në Komunë, duke shpresuar që të kemi sa më pak raste të veprave të ndryshme të raportuara dhe me shpresën që në raportin e mbledhjes së ardhshme shifrat e prezantuara sot do të jenë shumë më të ulëta.

z. Nijazi Jashari, theksoi, desha të bëjë një plotësim të raportit, fjala është për rastet e dhunës në familje, që janë bukur shqetësuese. Deri më tani janë të lajmëruara 62 raste. Në orët e mbrëmjes në fshatin Gllamnik ka ndodhur një rast i dhunës në familje që ishte shumë shqetësues.

z. Qefser Behrami, sa i përket trafikut në rrugën Podujevë- Pollatë mbi lumin llap te ura, është një dëmtim i rrugës jo i vogël dhe si rezultat i kësaj shpesh herë ka pas edhe aksidente në komunikacion për shkak të asaj grope. Ky dëmtim është lajmëruar edhe më herët, është intervenuar pak por jo mjaftueshëm dhe dëmtimi vazhdon të mbetet dhe nëse nuk sanohet mendoj se gjatë sezonit dimëror do të jetë një rrezikshmëri e madhe për komunikacionin.

z. Bahri Selimi, ne jemi në dijeni për dëmtimin e rrugës të cekur nga parafolësi sepse e kemi marrë këtë informatë më herët, por meqë rrugët regjionale dhe rajonale janë në kompetencë të Ministrisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes së Mjedisit dhe Infrastrukturës, e gjitha çka ne mund të bëjmë është që të kërkojmë prej tyre që të intervenohet. Ne kemi kërkuar disa herë dhe jam në dijeni se dy herë është intervenuar në të njëjtin vend dhe megjithatë nuk është kryer puna si duhet. Ne sot do u drejtohem me një shkresë Ministrisë së cekur dhe të shpresojmë se do të intervenojnë me kohë, sepse sipas informacioneve që i kemi janë disa probleme që i kanë lidhur me kontratën për mirëmbajtjen e rrugëve regjionale sepse kërkesë të ngjashme kemi edhe për rrugën për në fshatin Dumnice në dalje të qytetit të Podujevës, ku është dëmtuar rruga dhe janë bërë disa gropa në njërin shirit të rrugës dhe mundësia për aksidente është shumë më e madhe, ndërsa Ministria nuk është përgjigjur duke iu referuar një kontrate të skaduar, ndërsa nuk jemi të informuar për lidhjen e ndonjë kontrate të re. Ne do të konsultohemi dhe do të marrim një përgjigje prej Ministrisë. Nëse dikush nuk ka diçka rreth kësaj, kalojmë në pikën e radhës.

3. Informatë për sigurinë në shkolla

z. Bahri Selimi, fjalën për këtë pikë fillimisht e ka Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Avni Fetahu.

z. Avni Fetahu, theksoi, Drejtoria e Arsimit ka një plan të punës për këtë vit, gjithashtu edhe një raport të publikuar në ueb faqen e Komunës, ku pasqyrohen të dhënat e përgjithshme, e një nga pikat është edhe siguria në shkolla. Sikurse jeni në dijeni këtë vit kemi filluar pak me vonesë për shkak të grevës dhe disa plane janë shtyrë që i kemi pas në koordinim me Policinë e Kosovës. Tani më është harmonizuar koha edhe për ligjërata dhe për format tjera që ndikojnë në vetëdijesimin më të lartë të sigurisë në shkolla. Fat i mirë është që këtë vit kemi filluar në të gjitha shkollat me sistemin e sigurisë së kamerave dhe kjo e ka lehtësuar punën bukur shumë si për Policinë por të njëjtën kohë edhe për shkollat që situata të menaxhohet sa më mirë. Pas një periudhe bukur të gjatë kohore prej 10 vitesh kemi miratuar një Rregullore unike sepse nuk ka pas një të tillë sepse secila shkollë ka pas rregullore në vete. Rregullorja e re është në funksion të shkollave që nga

data 01 shtator 2022. Një sfidë me të cilën jemi duke u ballafaquar që ka të bëjë me sigurinë e nxënësve është çështja e transportit dhe dua të theksoj sikurse jeni në dijeni me ngritjen e çmimit të naftës njëkohësisht janë rritur edhe kërkesat apo apetitet e kompanive për shfrytëzim të buxhetit të Komunës sa më shumë, buxheti i cili edhe ashtu nuk është i lartë në këtë fushë. Proceduralisht po supozojmë nëse një vijë e transportit ka kushtuar 10000 €, Komuna ka mundësi për rritje deri në 30%, të shkojë deri në 13000 € të marr obligime financiare, por të vjen oferta e operatorit për një linjë 38.000 € për 56 nxënës, ne me 38000 € mund të ndërtojmë një shkollë në ndonjë lagje duke bërë zgjidhje, kështu që e kemi ritenderuar projektin për transportin e nxënësve sepse në prokurim kanë aplikuar me oferta skajshmërisht të larta, andaj jemi vonë pak për këtë çështje dhe jemi duke u mundur të gjejmë një rrugë ligjore në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, që edhe pse ndonjë keq klasifikim i vogël i parasë publike në orientim, jo në formë tjetër, kemi menduar për ndarje të shumës së mjeteve financiare atyre 570 nxënësve që kanë nevojë për transport dhe atë përmes llogarive bankare të prindërve të tyre, në mënyrë që ata të bëjnë zgjedhjen e transportit në formë individuale. Kjo për Komunën ka një kosto më të lirë dhe ata (nxënësit si shfrytëzues të transportit) do të jenë në një situatë më të mirë, dhe në një mënyrë eliminohen këto apetite të paarsyeshme të operatorëve ekonomik që e kryejnë shërbimin e transportit me çmime ekstrem të larta. Kjo ishte informatë në pika të shkurtra, për më në detaje është raporti i DKA-së i publikuar në ueb faqe të Komunës.

z. Shemsi Jashari, nga ajo që dëgjuam nga Drejtori, rezulton që të gjitha shkollat janë të pajisura me kamera të sigurisë, pyetja është se kush menaxhon me kamera, a ka ndonjë qendër të menaxhimit për të gjitha shkollat apo ka staf profesional që bën menaxhimin e kamerave.

z. Avni Fetahu, theksoi, menaxhimi i kamerave bëhet nga drejtorja e shkollës. Në shkollat ku ka profesor të teknologjisë informative kanë ofruar një mbështetje profesionale më të mirë. Informatat që sigurohen me dëshmi të videove, në shumicën e rasteve lëshohen me urdhër të prokurorit, e në disa raste edhe Policisë u ofrojmë informata. Pra sistemi i kamerave menaxhohet brenda shkollave nga drejtori apo prej stafit profesional të Teknologjisë Informative. Është arkivi ku ruhen të dhënat për një periudhë kohore një javore, ku regjistrohen në hard disk.

z. Qefser Behrami, theksoi, kur kemi të bëjmë me transportin e nxënësve, unë kam një vërejtje të vogël, udhëtimi i nxënësve nga fshati Çenogë në shkollën në fshatin Pakashticë që është aneks i shkollës së fshatit Kërpimëh, paraqet problem, sepse është vend malor, e nuk përjashtohet rreziku edhe nga kafshët e egra, kështu që është i nevojshëm transporti. Çështje tjetër që vlen të theksohet, është se asnjëherë si deri më tani shkolla e fshatit Kërpimëh nuk ka qenë më e pajisur dhe kompletuar me të gjitha kabinetet e nevojshme për shfrytëzim nga nxënësit dhe mësimmshënësit. Si vërejtje tjetër, që rezulton edhe nga banorët përreth, në veçanti nga prindërit e nxënësve, çështje të cilën e kam potencuar edhe në mbledhjen e KLSB-së në fshatin Kërpimëh, është ngasja e veturave me një shpejtësi të shfrenuar afër shkollës, por përveç tyre këtu problem janë edhe transporti i masave drusore që janë keqpërdorues të pyjeve që po ashtu qarkullojnë pran shkollës me ngarkesë të madhe gjë që mund të rrezikojnë nxënësit. Lidhur me këtë një kohë të gjatë kemi kërkuar të vendosen pengesa në rrugë për të ndikuar në ngadalësimin e shpejtësisë së automjeteve. Kamerat e sigurisë shkollë i kemi që moti dhe janë donacion nga OSBE-ja, megjithatë kemi nevojë për instalimin edhe të 2-3 kamerave shtesë sepse janë të nevojshme për rrugën që shpie në drejtim të fshatrave Pakashticë dhe Çenogë.

z. Nuhi Selimi, po ndërlidhem me fshatin Orllan sa i përket transportit të nxënësve. Drejtori foli për çështjen e transportit të nxënësve, por dy muaj të mos ketë transport të nxënësve nuk është në rregull. Prej fshatit Brainë deri në Bërvenik për të udhëtuar nxënësit në këmbë është bukur vështirë. Drejtori e potencoi si mundësi për të bërë marrëveshje me prindërit e nxënësve sa i përket transportit, shtrohet pyetja ndoshta prindërit nuk kanë edhe automjete, kështu që është problem të realizohet. Shpresoj që transporti të sigurohet sa më shpejtë. Pastaj desha të informohem edhe sa i përket furnizimit me lëndë djegëse, sepse në rajonin e Orllanit është më ftohtë, dhe në mëngjes nxënësit kanë shumë nevojë tu sigurohet ngrohja.

z. Avni Fetahu, theksoi, te çështja e transportit, sikurse jeni në dijeni mësimi ka filluar më datën 3 tetor 2022 dhe jo që dy muaj sikurse e potencoi parafolësi. Procedurën prokurimit për transportin e nxënësve kemi filluar si asnjëherë më parë prej muajit qershor dhe këtu i kanë afatet kohore procedurale dhe të ankesës. Një nga operatorët ekonomik që është i njohur për ju dhe ne, i cili ka 20 vitet ka kryer shërbimin e transportit për nxënës, ka paraqitur ankesë lidhur me lëndën dhe e njëjta është në OSHP. Mendoj se atë që e theksova paraprakisht do të ishte një zgjedhje e mirë, dhe do të menaxhohej më mirë nga prindërit e nxënësve çështja e sigurimit të transportit. Sa i përket ngrohjeve që u potencua, me pelet dhe me dru, sa për informim kemi pas një kontratë kornizë dy vjeçare dhe jo vetëm në Komunën tonë por në të gjitha komunat për shkak të rritjes së çmimit të drurit peletit janë tërhequr kompanitë. Si rrjedhojë ne kemi zhvilluar procedurë të prokurimit dhe ditën e nesërme pritet nënshkrimi i kontratës dhe do të fillohet me shpërndarjen e masës drunore nëpër shkolla.

z. Nuhi Selimi, theksoi, diskutimi im nuk pat ndonjë qëllim të akuzimit për askënd, mirëpo duke i njohur kushtet shkollore për fëmijët atje ndjeja si obligim që këtë ta potencoj dhe shpresoj në zgjidhjen e këtij problemi duke i stimuluar prindërit për çështjen e transportit edhe pse nuk mendoj se do të ketë zgjidhje, ndërsa sa i përket ngrohjes për shkollë, shpresoj që kjo të zgjidhet sa më shpejtë.

z. Bahri Selimi, nëse nuk ka dikush tjetër për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

4. Informatë për gjendjen e pyjeve

z. Bahri Selimi, fillimisht fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z.Fatmir Rudari.

z.Fatmir Rudari, theksoi, sipërfaqe me pyje në territorin e Komunës së Podujevës janë gjithsejtë 29050 ha, prej të cilave në sektorin shoqërorë janë 17600 ha, ndërsa në sektorin privat individual janë 11450 ha. Kjo sipërfaqe e pyjeve është e ndarë në tri njësi menaxhuese; Popovë-Llapashticë, Murgull-Bellasicë dhe Turuqicë të cilat shtrihen në 12 rajone ekonomiko pyjore dhe menaxhohen nga 12 roje të pyllit. Në sektorin e pylltarisë kryhet një numër i aktiviteteve dhe shërbimeve siç janë; bashkëpunon ngushtë me Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe zbaton në përpikëri politikat e sektorit, angazhohet në maksimum për zvogëlimin e prerjeve ilegale, sëmundjes dhe dëmtuesit dhe në pengimin e shfaqjes së zjarreve në pyje. Kryen shërbime për qytetarë të bëjnë shfrytëzimin e asortimentit drusor në mënyrë legale me leje për prerje në pyje private, punon në zbatimin e projekteve në pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura, raporton në bazë mujore në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Aktivitetet e zhvilluara në sektorin e pylltarisë gjatë periudhës janar-qershor 2022:

- Janë konfiskuar rreth 240 m³ dru zjarri dhe 19.10 m³ dru teknik nga prerësit ilegal në pyjet publike.

- Janë shqiptuar gjithsejtë 187 fletëparaqitje kundërvajtëse dhe 38 fletëparaqitje penale, çka do të thotë se mbi 2 m³ kalon si kategori e veprave penale .

Janë përfunduar 6 revizione pyjore në rajonet ekonomike pyjore; Dumnicë, Llaushë, Popovë, Sylevicë, Sekiraqë dhe Turuqicë, me qëllim të konstatimit dhe regjistrimit të gjendjes ekzistuese sa i përket dëmeve pyjore, me ç'rast vlera totale e dëmeve të konstatuara është 337.72 m³, prej të cilave të arsyeshme kanë qenë 251.30 m³, me gjithsejtë 139 fletëparaqitje. Në të gjitha këto aktivitete unë e kisha falënderuar Policinë e Kosovës ku pa bashkëpunimin dhe asistencën e tyre ne nuk do të mund të zhvillonim të gjitha këto aktivitete.

Në baza javore kemi plan operativ së bashku me Policinë e Kosovës për pengimin e prerësve ilegale që janë duke i dëmtuar pyjet në territorin e Komunës së Podujevës.

z. Qefser Behrami, sa i përket çështjes së pyjeve në takimin e KLSB-së ka qenë prezentë edhe Komandanti i Stacionit Policor, shumica e përfaqësuesve të fshatrave të atij rajoni vërejtjet më të mëdha i kanë sa i përket prerjes së pakontrolluar të pyjeve si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Pra çështja është që të ndërmerren masa dhe të gjendet format e ndaljes së prerjes në masë të madhe të pyjeve dhe keqpërdorimeve të tyre. Është dukuri se të gjithë ata persona që janë në pozitë të mirë ekonomike janë duke i bërë këto keqpërdorime me pyjet dhe për qëllime biznesore. Kërkohej një mbikëqyrje dhe kontroll më e madhe nga Stacioni Policor, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe nga institucionet tjera relevante.

z. Fatmir Rudari, theksoi, ne jemi në dijeni se gjendja e pyjeve nuk është e mirë në Komunën e Podujevës, por duke pas parasysh se nuk ka ndonjë alternativë tjetër për ngrohje dhe e vetmja zgjidhje është me dru kjo ka rezultuar në gjendjen që kemi, por ne kemi pas 298 kërkesa për leje për prerje të pyjeve, prej tyre 160 janë miratuar, kjo nënkupton që pjesa më e madhe janë me dokumentacion në rregull. Ne si autoritet komunal bashkë me Policinë e Kosovës çdo ditë bëjmë kontrole të përbashkëta, i kontrollojmë dokumentacionet, por nuk do të thotë se nuk ka edhe prerës ilegal të pyjeve. Me kapacitetet tona bashkë me Policinë jemi në terren për të legjitimuar se a janë në rregull apo jo. Me pyjet në Komunën e Podujevës menaxhon Agjencia e Pyjeve të Kosovës, ndërsa ruajtjen e bën Komuna e Podujevës. Gjithashtu lejet për prerje të pyjeve i lëshon Agjencia, ndërsa ruajtja bëhet prej pylltarëve tonë, të cilët e kanë një punë mjaftë të rrezikshme, sepse nuk ka pylltar i cili nuk është sulmuar fizikisht së paku 2 apo më shumë herë apo që nuk është fyer, ndërsa paga e tyre është 300 € dhe në detyrë janë 24 orë.

z. Nijazi Jashari, theksoi, falënderoj Drejtorin për statistikën e prezantuar. Policia lidhur me këtë vepron sipas Planit operativ. Vetëm desha të ilustroj një rast, para 10 dite kemi pas një plan operativ së bashku me Inspeksionin e Agjencisë Pyjeve të Kosovës dhe sa për informatë vetëm një traktor duke transportuar dru është hasur pa dokumentacion.

z. Avni Fetahu, theksoi, në një periudhë kohore kemi bërë një harmonizim të mirë në koordinim me Bashkësinë Islame por edhe në shkolla është mbajtur një fushatë vetëdijesuese ku patëm shtypur edhe disa broshura, jemi harmonizuar se është folur edhe për rëndësinë ruajtjes së pyjeve. Pra ndoshta është mirë të harmonizohemi në funksion të ngritjes së vetëdijesimit.

z. Mensur Hoti, theksoi, ne jemi të gatshëm për çdo lloj bashkëpunimi. Edhe në të kaluarën kemi fol për dëmtimet e pyjeve, dukuritë negative në xhamitë e Komunës sonë dhe prapë jemi për bashkëpunim.

z. Bahri Selimi, nëse nuk ka dikush tjetër për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

5. Informatë për sigurinë në komunikacion dhe trajtimi i qenve

z. Bahri Selimi, theksoi, nga fushëveprimi i kësaj teme më takon mua të ju informojë për gjendjen aktuale, me theks për trajtimin e qenve endacak. Sa i përket sigurisë në trafik është temë që po ashtu u diskutua gjatë procesit të raportimit të bërë nga Komandanti i Policisë, i cili informoi edhe për statistikën. Gjithashtu u diskutua edhe për Planin e Mobilitetit që ndër tjera ka për qëllim dhe është në funksion të ofrimit të sigurisë më të madhe në komunikacion, dokument i cili është në proces të diskutimit publik dhe mendojmë që përfundimisht të dalim me një Plan të mirë. Ne jemi të vetëdijshëm se trafiku në Komunën tonë nuk është aq në nivel të sigurisë për shkak të rrugëve të pamjaftueshme, rrugëve të ngushta, disa prej tyre një drejtimshe, të cilat si nevojë për ngritje të sigurisë duhet të bëhen dy drejtimshe. Si rrjedhojë në të ardhmen po mundohemi që duke u bazuar edhe në propozim Rregulloren për transportin që e kemi në diskutim publik dhe propozim Planin e mobilitetit do ta rregullojmë gjendjen e sigurisë në komunikacion. Po fokusohem pak më shumë te trajtimi i qenve endacak. Është bërë një dukuri që në vazhdimësi po na sjell probleme. Problemet për trajtimin e qenve endacak nuk janë vetëm probleme komunale, por më të gjëra, mund të them që janë probleme në nivel vendi. Lidhur me këtë problematikë kemi mbajtur takime edhe me disa komuna tjera të cilat hyjnë në regjionin e qytetit të Prishtinës ku jemi munduar ta trajtojmë më shumë këtë temë. Si komunë në fillim të vitit kemi lidhur një kontratë me një operator ekonomik ose kompani e cila merret me trajtimin e qenve endacak, mirëpo jemi të vetëdijshëm që çdo kontratë që e lidhim nuk është e mjaftueshme. Gjatë kohës kontraktuese apo kur kontrata është aktive në masë bukur të madhe bie numri i qenve endacak, sepse trajtohen qentë. Sa për informim kontrata të ngjashme lidhin edhe komunat tjera. Si dukuri më negative që unë kam vërejtur është bartja e qenve endacak nga një komunë në tjetrën dhe kjo situatë është duke paraqitur problemet më të mëdha dhe kjo dukuri mbetet e pa evituar. Në bazë të statistikave apo raportit që më është ofruar nga kjo kontratë, e cila tashmë është në fazën përmbyllëse, rezulton që gjatë kësaj kohe janë trajtuar gjithsejtë 223 qenë endacak, dmth është bërë zënia dhe vlerësimi i gjendjes shëndetësore të tyre. Të trajtuar që nënkupton ushqimin, kontrollin, vaksinimin, identifikimin etj. janë gjithsejtë 202 qen endacak. Të vaksinuar kundër tërbimit dhe sterilizuar 202 qen endacakë. Me ligjin për përkujdesjen ndaj kafshëve qentë pas trajtimit të tyre sërish kthehen në vendin e zënies. Prej tyre janë asgjësuar me vaksinim 21 pasi që është vlerësuar se nuk janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe paraqesin rrezik për të tjerët. Kjo ishte sa i përket kontratës, mirëpo nuk është një kontratë që ka zgjidhur problemin, sepse më vonë gjendja është përqekësuar prapë. Për vitin e ardhshëm kemi ndarë prapë mjete buxhetore dhe do të lidhet një kontratë e re. Mirëpo sa do që po lidhim kontrata dhe ndajmë mjete financiare, po rezulton që të mos jenë efikase për arsyet që u cekën më herët. Kemi shumë raste ku besoj që edhe Policia është në dijeni kur operatorë ekonomik janë zënë duke i bartur qentë dhe i kanë lëshuar në zonat tona, kështu që po ndikohet në rritjen e numrit të tyre dhe kjo nënkupton që të fillohet prapë me trajtimin e tyre. Përfundimisht mund të them se nuk është duke u zvogëluar numri i tyre, sepse sikurse e përmenda problemi është edhe më i gjerë. Jemi në bashkëpunim dhe kemi takime të përbashkëta me Komunën e Prishtinës dhe do të shohim mundësitë për caktimin e një vend stacionimi për qentë endacak. Komuna e Prishtinës ka bërë përpjekje, por pengesat kanë dalë rreth pronës. Neve na mbetet të shohim për hapat që do i ndërmarrim në vazhdim.

z. Qefser Behrami, theksoi, çështja e trajtimit të qenve endacak ka qenë temë që është diskutuar shumë herë. Nënvizoi, mua personalisht më ka ndodhur që jam sulmuar nga

qentë, por gjithashtu ka ndodhur disa raste që janë sulmuar edhe fëmijët dhe si rezultat i kësaj ka ndodhur një javë që një nxënës të mos vijë në shkollë shkak i qenve endacak. Mendoj se duhet gjetur edhe metoda tjera, e pse jo edhe të asgjësimit. Nënvizoi, desha të kthehem mbrapa në temën që ishte lidhur me pyjet, vetëm desha të shtoj që në rrugën e Kravecit që lidhet me fshatin Pakashticë keqpërdoruesit e druve të cilët nuk kanë dokumentacion të transportit po e shfrytëzojnë këtë rrugë qarkullimi dhe po kalojnë nëpër ara dhe prona private ku janë duke shkaktuar dëme shumë të mëdha në toka bujqësore.

z. Bahri Selimi, theksoi, lidhur me diskutimin e parafolësit dua të theksoj se kemi ligjin për mbrojtjen e kafshëve dhe nuk lejohet kurrfarë metode e asgjësimit të tyre, por duhet trajtuar në përputhje me parashikimet ligjore. Nënvizoi, jemi duke u munduar të bëjmë një zgjidhje afatgjate dhe jemi duke punuar në këtë drejtim. Nëse nuk ka dikush tjetër për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

6. Të ndryshme

z. Bahri Selimi, nëse dikush ka diçka në kuadër të kësaj pike mund të marrë fjalën.

z. Shemsi Jashari, theksoi, kam një kërkesë që të na lejohet për parkimin e veturave në parkingun e Komunës gjatë kohës sa jemi në takime të KKS-së. Fjala është vetëm datën kur mbahet mbledhja e KKS-së, sepse po kemi vështirësi në gjetjen e parkingut, ka raste që të parkojmë edhe në fund të qytetit. Mendoj se kjo nuk është luks, nuk është e pamundur dhe nuk e pengojmë fare Komunën dhe kjo ndodh një herë në muaj apo në dy muaj.

z. Bahri Selimi, theksoi, kërkesën e z.Jashari do ta shqyrtojmë, sepse ka edhe kërkesa tjera të ngjashme gjatë mbajtjes së takimeve tjera, mendoj se do të bëjmë një zgjidhje.

z. Qefser Behrami, theksoi kam një kërkesë dhe nuk është e natyrës personale por që referohet edhe për anëtarët tjerë të KKS-së, fjala është për mos pagesën e mëditjeve për takimet e KKS-së. Shtrohet pyetja se a është shkelur ligji atëherë kur është bërë kompensimi apo tash. Unë jam në marrëdhënie pune por nuk mund të bëjë shpenzime për aktivitetet të lira. Pse të mos na paguhet mëditjet kur na takojnë me ligj. Më parë këto mëditje janë paguar. Unë jam i angazhuar në këtë aktivitet por gjithashtu kam obligim për mbajtjen e familjes. Unë në këto aktivitete bëj shpenzime të transportit. Mua më kanë nominuar sipas pozicionit që kam në KLSB, përndryshe edhe sot po të largohem nga ky Këshill nuk e kam problem.

z. Bahri Selimi, kërkesën e cekur nga parafolësi veç se e kemi trajtuar me Drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe i njëjti ka konfirmuar se bazuar në rregullativën ligjore nuk bëhet kompensimi për aktivitete të zhvilluara brenda orarit të punës, me përjashtim të atyre anëtarëve të cilët nuk janë pjesë e shpenzimit të buxhetit. Megjithatë ne po e marrim si kërkesë dhe do të keni përgjigje në mbledhjen e radhës.

z. Shemsi Jashari, theksoi, rreth çështjes së mëditjeve mendoj se është e nevojshme të njoftohet Këshilli me bazën ligjore, në mënyrë që të jemi të gjithë të informuar lidhur me kompensimin e anëtarëve.

z. Bahri Selimi, gjithsesi në mbledhjen e radhës sikurse e theksova do të informoheni lidhur me çështjen e mëditjeve për mbledhjet e KKS-së.

z. Liman Zeqiri, theksoi, falënderoj të gjithë për kontributin e tyre në këtë takim të Këshillit, por unë kisha sugjeruar, nëse ka mundësi edhe sekretarisë së juaj që paraprakisht kur përgatitet rendi i ditës për mbledhje të KKS-së do të ishte mirë të na dërgohen edhe materialet (informatat etj.) përkatëse. Sikur të kishim informatat në formë shkruar, mendoj dhe jam i sigurt se debatet do kishin me qenë më të fokusuara. Pra qëllimi është që të parapërgatitemi për takim, sepse është e pamundur që të gjitha ato

statistika dhe informata të shënohen në takim. Prandaj sot janë të gjitha kushtet duke iu falënderuar të arriturave teknologjike që materialet të përcillen me thirrjet e rendit të ditës. Kërkesa është që në të ardhmen kjo të aplikohet.

z. Bahri Selimi, theksoi se edhe unë mendoj se duhet vepruar sikurse e theksoi parafolësi dhe sekretaria do të merr përbazë këtë.

Nëse nuk keni diçka tjetër për të shtuar, unë e përmbyll takimin, ju falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani



Nr. prot.02-060/04-89290/22

Podujevë, datë:19.10.2022

Kryetari i Komunës

Shpejtim Bulliqi

